

Oral History Kosovo

KUFIRI MES NESH

Nga Ulpiana Lama

Isha fëmi kur për të parën herë vizitova veriun e Shqipërisë. Nuk më kujtohet dita, por me ç'më tregon mamaja ime, Gazmira, ka qenë nëntori i vitit 1980. Sjell ndërmend pak gjë nga ai udhëtim. Faktin që ishte emocional... udhëtonim vetëm unë dhe im atë. Motra ime, Venera, sapo kishte mbushur 11 muaj dhe mamaja qëndroi në shtëpi me të. Di të them që nuk ishte një udhëtim turistik, përndryshe do isha përqëndruar te rrugëtimi, jo destinacioni. Kujtoj liqenin, ujërat blu thuajse në të gjelbërt si dhe tragetin. Kujtoj po ashtu një rrugë të ngushtë me gropa, ose jam duke e ngatërruar me një tjetër rrugë të ngushtë me gropa, aq të zakonata në Shqipërinë e kohës.

Im atë dhe unë kishim një qëllim. Ndërmorrëm atë udhëtim tetë orësh nga Tirana për të arritur në kufirin me Kosovën dhe pritur prindërit e tij; ata i'a kishin dalë të merrnin vizat për të ardhur në Shqipërinë e komunizmit të egër të Enver Hoxhës. Isha e emocionuar sepse do t'i takoja gjyshërit për të parën herë. Në fakt, edhe babai im po i shihte të vetët për të parën herë që prej 1959-ës. E kishte lënë qytetin e lindjes si 17 vjeçar, atëherë kur të rinjtë u lanë jashtë sistemit shkollor, sajë një vendimi të ministrit famëkeq të Punëve të Brendshme, Aleksandër Rankoviç, për ta mbyllur gjimnazin e vetëm të Gjakovës.

Një numër adoleshentësh, djem dhe vajza, u larguan drejt Shqipërisë për të vazhduar studimet. Di pak rreth aventurës së tyre sepse im atë nuk fliste fort rreth saj. Çka di me siguri është se ata – një grup të rinjsh idealistë – e kaluan kufirin ilegalisht. Gjakova ndodhet shumë pranë Kukësit. Me të mbërritur në Shqipëri, ku kujtonin se ishin të sigurt, një pjesë e madhe u dërguan në kampet e punës në Lushnjë. Babai im qëndroi atje për dy vjet. Nuk e pati të lehtë. E sillte në kujtesë atë periudhë si ndër më të vështirat. Për 35 vjet i'u ndalua hyrja në Kosovë dhe mundësia për ta parë familjen.

Ne ruajmë ende shumë fotografi të familjarëve tanë në Kosovë. Këmbenim rregullisht fotografi dhe në fakt, gjithçka rreth tyre e mësonim vetëm përmes fotove. Gjyshja nga ana e mamasë, Sanija, ishte po ashtu nga Gjakova. Burri i saj – gjyshi nga mamaja, Aliu - ishte tregtar. Fundi i Luftës së Dytë Botërore i gjeti në Shqipëri. Vendosën të qëndrojnë. Sanija dhe Bashkimi merreshin vesh shumë mirë bashkë. Mbaj mend fort mirë kur flisnin për njerëzit, lagjet dhe ngjarjet në Gjakovë. Ishte një ushtrim kujtese, besoj. Më shijonin pa fund bisedat e tyre që zgjasnin për orë të tëra mbrëmjeve, atëherë kur Sani- ja, të cilën ne e thërrisnim thjesht *nona*, vinte për të fjetur tekne.

Në nëntor të 1980-ës, në vijën kufitare, takova pra për të parën herë gjysmën e familjes - halla, xhaxhallarë, kushërinj. Nuk i kisha parë kurrë më parë dhe në fakt, as që arrita t'i takoj. Thjesht i shihja pas shpinave të rojeve kufitare, të cilët nuk na lejuan të afroheshim. Mendoj se duhet të ishin diku te 40 të afërm. Nuk i shquaja mirë fytyrat e tyre nga 100 metra distancë. Skenë sureale. As nuk kam foto nga ato momente ngaqë ndaloheshin aparatet.

Çfarë gëzimi kur i takova gjyshërit – Mustafa dhe Fatime Neziri. Kanë qenë zejtarë - orëtarë të kthyer më vonë në optikanë. Më sollën sende të mrekullueshme dhe papritmas, unë u shndërrova në gocën më moderne të shkollës. Oh me sa dashuri dhe ngrohtësi e mbushën shtëpinë!

Qëndruan një muaj. Gjyshi dhe babi nuk para flisnin për të tashmen. Me sa kujtoj, asnjëherë nuk e përmendën politikën. Druheshin nga përgjimet? E injoronin me vetëdije?

Nuk e harroj momentin kur gjyshërit u larguan. Për shumë arsye, e ndoshta mbi të gjitha sepse për të parën herë pashë tim atë të qajë. Ishte tronditëse për mua. Babai im ishte burrë i fortë, pothuaj kurrë nuk e tregonte anën e tij të butë. U ndjeva shumë e vetmuar pas largimit të tyre.

Ne e vizituam Kosovën për të parën herë në fillim të 1994-ës, 35 vjet pas migrimit të tim eti. E mbaj mend tejet të emocionuar gjatë qëndrimit tonë atje, tre javë të plota. Tre javë të shkëlqyera, gjatë të cilave kemi festuar pa fund, të ftuar nga të afërm e miq në dreka e darka. Periudhë frenetike. Ishin mbledhi që për nga numri i të ftuarve dhe ushqimi i shtruar ngjanin me dasma. Mahnitëse!

Im atë u nda nga jeta më 3 prill, 1998. Ditëlindjen e ka më 28 nëntor, festën tonë kombëtare. Në 1999-ën, një vit pas vdekjes së tij dhe katër muaj pas përfundimit të luftës, unë dhe im shoq, Ardiani, vajtëm në Kosovë. Një homazh nga zemra sepse, jam e sigurt, nëse do të ishte gjallë im atë nuk do donte ta festonte ditëlindjen askund tjetër përveçse në Kosovën e lirë.

Kalova nëpër të njëjtin itinerar vjeshtën e kaluar. Kësaj here bëra fotografi. Ja një prej tyre: më pëlqen lumi dhe krejt simbolika që e shoqëron. Gjithcka ka shumë më tepër dritë se në kujtimet e mia...